



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 24.04.2025
Numër protokolli: 2751/2025

A.nr.357/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërja nga: Eshref Shabani- kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari anëtarë, me Sabile Avdyli-në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.357/2025, të datës 25.02.2025, të parashtruar nga ankuesja F.S., kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.04.2025 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës nën shenjën A.nr.357/2025, të datës 25.02.2025, të parashtruar nga ankuesja F.S.

A r s y e t i m

Ankuesja F.S. (*referuar tutje ankuesi*), më datë 25.02.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për kompensimin për funksion shtesë sipas vendimit me Nr.286 të datës 22.04.2024 për Krijimin e Task-Forcës së Gjellbër.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) referuar shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Kolegji i Këshillit pas pranimit të Përgjigjes në ankesë nga Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka konstatuar se u.d Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI me vendimin me numër protokolli 1354/25 të datës 07.03.2025 ka aprovuar kërkesën e datës 31.01.2025 të znj.F.Sh. e punësuar në pozitën Inspektor i Tregut-për cilësi dhe tregti të derivateve të naftës në Departamentin Inspektorati i Tregut në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Andaj, duke qenë se me Vendimin me numër protokolli 1354/25 të datës 07.03.2025, i nxjerr nga u.d. Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI është aprovuar kërkesa e ankueses, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të Ligjit

Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”.***

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.357/2025, të datës 25.02.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.357/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses F.S.;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.